

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajten e sistemeve të rrjetit dhe infrastrukturës teknologjike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT - 32412000-4 - Rrjet i komunikimeve.

VLERA E FONDIT LIMIT: - 99,841,790 (nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e nentëdhjetë) lekë, pa TVSH, ose **1,038,720.24** (një milion e tridhjetë e tete mijë e shtatëqind e njëzet pikë njëzet e kater) euro pa TVSH. *Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 05.05.2026, 1 euro = 96.12 All.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme, sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem mirembajtje, upgrade, zgjerim dhe permiresim te infrastruktures aktuale. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ..3 ;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi 2.2.1 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998, datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertes, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Argumentim 2.2.2: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshëm) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektivit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të kryesohet vijimi i mirëmbajtjes dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Certifikimi **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjive të informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresi i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin për të gjithë produktet **Garanci për Suport për sistemet ekzistuese** të autoritetit kontraktor, objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota me objekt dhe numer referencë të procedurës dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licensimeve specifike që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve/shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve me të larta nga prodhues me famë të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikën e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve/shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se një pjesë me dërmuese e prokurimit është vazhdimësi për sisteme ekzistuese që janë funksionale dhe tepër të rëndësishme. Operatorët Ekonomikë duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor

se keta operatore ekonomike kane te drejta per te rishitur keto produkte/licensa/sherbime, ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e procesit nga te njejtet prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. 2.3.4 Operatori pjesemarres per te vertetuar qe ka kapacitete njerezore profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe dhe sipas termave te references te projektit, duhet te vertetoje se ka jo me pak se 10 (dhjete) Inxhinier/Specialiste te diplomuar ne deget e Inxhinierise Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Matematike / Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion qe do te angazhohen ne implementimin e projektit, ku te vertetohen nepermjet diplomes për të paktën muajin e fundit (*duke marr si reference daten e hapjes se tenderit*), ne menyre te kombinuar te kene Çertifikatat perkatese (si meposhte) si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise minimumi per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave, nga te cilet:
 - a) Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certifikate per “Project Manager”, ose ekuivalente;
 - b) Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar CIR “Certified Incident Responder”, ose ekuivalente;
 - c) Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar “Cyber Threat Hunting Professional”, ose ekuivalente;
 - d) Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certifikate per menaxhimin e sherbimeve ITIL, ose ekuivalente;
 - e) Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Penetration Tester, ose ekuivalente;
 - f) Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional CCNP Routing & Switching për rrjetin nga prodhuesi për te mirëmbajtur garancinë për suport për pajisjet ekzistuese te rrjetit, ose ekuivalente;
 - g) Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional “CCNP” per sigurine nga prodhuesi për te suportuar zgjidhjet ekzistuese te sigurisë, ose ekuivalente;
 - h) Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel ekspert (CCSE) nga prodhuesi për te mirembajtur dhe suportuar zgjidhjen ekzistuese Checkpoint, ose ekuivalente;
 - i) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional për te suportuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese Manage Engine, ose ekuivalente;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat perkatëse të kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet të vertetojë se i ka të punësuar për periudhën e dates së hapjes së tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- *Certifikatat perkatëse të kualifikimit për secilin nga specialistet e mesiperm.*
- *Listepagesat e punonjësve dorëzuar nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, për muajin e fundit(duke marr si reference datën e hapjes së tenderit);*

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Argumentim : Qellimi dhe objektivi final i ketyre kriterëve është mosnderprerja e shërbimeve shume te rendesishme te ofruara perdite nga punonjesit dhe sistemet teknologjike te Oshee Group sha, sigurimi i vijimësise se punës, mos rrezikimi i ekspozimit te te dhenave konfidenciale qe permbajne/grumbullojne e menaxhojne keto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve te pallogaritshme financiare zinxhir qe do shkaktoheshin ne rast nderprerjeje te proceseve te përditshme te punës si rezultat i mos-kryerjes se ketij prokurimi, ne kuader te progresit te vazhdueshem e te pandalshem teknologjik faktik te platformave ekzistuese dhe atyre qe do vijne ne te ardhmen e afert per Oshee Group sha.

Argumentim për kriterin në piken a):

Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Project Manager.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës dhe rendësisë operacionale që kanë sistemet të AK, ku të gjitha këto duhet domosdoshmërisht të ndiqen nga një profesionist i kualifikuar Project Manager ose ekuivalent në menaxhimin e projekteve nga fillimi (nenshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i mosrealizimit të kontratës për arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi është standard i kërkuar gjerësisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertizë të thelluar në menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe shërbën si një pikë referuese nga ana e AK gjatë zbatimit të kontratës

Argumentim per kriterin ne piken b):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist te certifikuar CIR “Certified Incident Responder”** për të vënë në zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast situatë gjendjeje nën sulm kibernetik. Ky çertifikim eshte vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithe profileve te eksperteve te sigurise kibernetike dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer teper te madh punonjesish qe do afektohen ne rast ndodhie incidenti pasi normalisht ndërthurin punen e tyre te përditshme per realizimin e objektivave te përditshme te Oshee Group sha;

Argumentim per kriterin ne piken c):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve, njohjen e dobësive apo preکشmerise ndaj ketyre te fundit, per ruajtjen e te dhenave që gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **2 (dy) specialist te çertifikuar Cyber Threat Hunting Professional** ose ekuivalente, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel Cyber Threat Hunting Professional, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet multinacionale jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore.

Argumentim per kriterin ne piken d):

Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certifikate per menaxhimin e sherbimeve ITIL ose ekuivalente, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, kete specialist duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet multinacionale jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar

ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore

Argumentim per kriterin ne piken e):

duke qene se objekti i prokurimit eshte siguria kibernetike me qellim testimin / parainformimin / trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten ***1 (nje) specialist te certifikuar si Penetration Tester ose ekuivalente***” për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizojte efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast situatave gjendjeje nën sulm kibernetik. Ky çertifikim eshte vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithë profileve te eksperteve te sigurise kibernetike dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e infrastruktures dhe platformave teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, qe aktualisht kane nje numer teper te madh punonjeshish qe do afektohen ne rast ndodhie incidenti pasi normalisht ndërthurin punen e tyre te përditshme per realizimin e objektivave te përditshme te Oshee Group sha;

Argumentim per kriterin ne piken f):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten ***2 (dy) specialist te certifikuar ne nivel profesional CCNP Routing & Switching ose ekuivalent***, për këte lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar “Routing and Switching”, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale CISCO jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese në, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Argumentim per kriterin ne piken g):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin

e tij, te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional CCNP Security ose ekuivalent për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar per sigurinë e rrjetit “Security”, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale CISCO jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Argumentim per kriterin ne piken h):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional CCSE Checkpoint** ose ekuivalent, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel Profesional për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar per sigurinë e rrjetit, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale Checkpoint jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Argumentim per kriterin ne piken i):

duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten **1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional ManageEngine** ose ekuivalent, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar per sigurinë e rrjetit, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale ManageEngine jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References, fondi limit , preventivi i detajuar dhe afati i realizimit të shërbimit, kriteret teknike për kualifikim, janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posacem nga titullari me nr.2016/1 prot date 02.03.2026, dhe janë percjelle me relacion nr. 2016/2 prot date 04.05.2026 pranë Njesise se Prokurimit. Specialisti i fushes pjese e njesise se prokurimit te krijuar me urdherin e prokurimit me nr. 2016/3 prot., date 05.05.2026 ka analizuar kriteret teknike te hartuara nga grupi i punes dhe i ka konfirmuar ato. Njesia e Prokurimit duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”i ndryshuar ka hartuar Dokumentat e Tenderit.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbime e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.